



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 12.05.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **07.05.2025** të parashtruar nga Operatori Ekonomik ANUAR SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik”, Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik “ANUAR” sh.p.k., e dt.07.05.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik”, Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 03.04.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, të publikuar me datë: **03.04.2025**;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

Arsyetim

Operatori ekonomik "ANUAR" sh.p.k. me dt.07.05.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i infrastrukturës në Liqenin Erenik", Nr. i prokurimit- 632-25-2687-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-25-035-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.05.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pika 1

Kërkesa 8 - 1 (një) Bachelor i Inxhinierisë së Ndërtimit – Drejtimi Hidroteknikë, i licencuar me licencë B nga Ministria e Mjedisit, i certifikuar për Menaxhimin e resurseve ujore, sasi, cilësi dhe shëndet, minimum 4 vite përvojë pune pas diplomimit dhe certifikimit – i cili duhet të jetë i trajnuar sipas modulit 3 për vlerësim preliminar i rrezikut nga përmbytjet.

-Përgjigje: Ju njoftojmë se sa i përket kësaj kërkesë dhe kërkesave tjera të tenderit këto janë kriteret minimale të cilat duhen të plotësohen që do të thotë se Inxhinieri i nivelit Master është mbi minimumin e kërkuar në tender. Pra pranohet niveli i Inxhinierit Master me certifikimet përkatëse siq është kërkuar tek kërkesa 8.

- Pika 2

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Në një vlerë prej jo më pak se 6.000.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.

-Përgjigje: pretendimi juaj nuk qëndron, sepse kërkesa është bërë në përputhje me nenin 25, paragrafi 25.13 i Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024:

25.13 "Qarkullimi specifik" i përmendur në paragrafin 1 të nenit 68 të LPP-së, i referohet qarkullimit që lidhet me një fushë të caktuar ose sektor që ka rëndësi për kontratën që po shpallet tenderi. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Operatori Ekonomik të dëshmojë që në përputhje me nenin 69 të LPP-së, në të kaluarën ka përfunduar kontrata të një natyre të ngjashme me një vlerë të caktuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, e cila nuk mund të caktohet më shumë se 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës. Kjo nënkupton se Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesën për qarkullim specifik nëse ka përfunduar një apo disa kontrata të një natyre të ngjashme që vetëm ose sëbashku arrijnë totalin e vlerës së specifikuar nga Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe nuk kërkohet që kjo kërkesë në vlerën e përcaktuar prej 1.5 herë vlera e parashikuar e kontratës të plotësohet vetëm me një kontratë të vetme të asaj vlere. "

- Pika 3

Pika 24 e renditjes tek Lista e Makinerive e cila është *Makinë shpuese gjeotermale, shpime për puse, shpime horizontale me sistem laserik të kontrollit*)

-Përgjigje:

Pretendimet tuaja lidhur me kriteret që kanë të bëjnë me makineritë janë të pa bazuara.

Autoriteti kontraktues konsideron se kërkesat në FDT, janë të domosdoshme, duke pasur parasysh natyrën e punës

Këto kriterë janë përcaktuar jo të kufizojnë konkurrencën dhe nuk përbëjnë pengesë për pjesëmarrje të drejtë në procedurë, por kanë për qëllim të sigurohet që operatorët ekonomik pjesëmarrës të kenë kapacitet për të përmbushur me sukses detyrimet që rrjedhin nga kontrata.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

